
progres ▶▶

Programi i partneritetit evropian me komunitat

Përmbledhje e raportit të dytë tremujor

1. janar – 31. mars, 2011.

NAACBE



•

Përmbledhje

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2011 janë ndarë më shumë se 600.000 euro për përgatitjen e planeve të rregullimit gjeneral dhe financimin e 40 projekteve nga Fondi për pjesëmarrje të qytetarëve, përderisa 300.000 euro shtesë janë ndarë për hartimin e dokumentacionit teknik për deponinë në Banjicë, projekti i largimit të mbeturinave nga lumi Lim dhe projekti kryesor i oborreve të reciklimit. Buxheti i përgjithshëm i Programit është rritur në 18.1 mmilion euro me aneksin e parë të kontratës me Delegacionin e Unionit Evropian.

Rezultatet e hulumtimit të parë të perceptimit të qytetarëve kanë shkaktuar interesim të madh të funksionerëve kumunal, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Rezultatet tregojnë se institucionet lokale mesatarisht gëzojnë besimin e 25% të qytetarëve kurse më shumë se gjysma e të anketuarve konsiderojnë se administratave komunale nuk i interesojnë nevojat e tyre. Nuk ka qenë e papritur që këto rezultate përsëri kanë vërtetuar rëndësinë e intervenimeve të parashikuara me anë të PROGRES-it.

Një nga rezultatet e përfaqësimit të PROGRES-it lidhur me Komponentën 1 është edhe themelimi i këshillit për barazi gjinore më tri komuna: Kurshumli, Blace dhe Zhitoragjë, përderisa Nova Varosh ka emëruar zyrtarin i cili do të merret me çështjet e barazisë gjinore.

Njëzet e katër komuna kanë dërguar 27 propozim projekte pas shpalljes së ftesës së parë për dërgimin e projekteve të vogla të infrastrukturës (aktiviteti 6.2) i cili është mbyllur më 28 shkurt. Të gjitha projektet kanë kaluar verifikimin administrativ dhe vlersimin e konceptit. Përveç kësaj, komunat e qarkut të Toplicës i kanë dërguar tetë propozime të projekteve të vogla të infrastrukturës (aktiviteti 6.1). Është definuar dhe parimisht është aprovuar Iniciativa e përkrahjes së zhvillimit të propozim projektit të Novi Pazarit. Gjatë punës së përhershme me të gjitha ekipet e projekteve të komunave është vërtetuar, se ekzistojnë sfida sistemore në pikëpamje të zhvillimit të infrastrukturës së re, duke filluar nga çështjet e katastrofit, administratave komunale për planifikim, statusi i dokumentacionit planor deri tek çështja e pronësisë ndaj tokës. Prandaj nuk mund të presim nga vetqeverisjet lokale që të posedojnë projekte plotësisht të përgatitura në të cilat në mënyrë sistematike do të aplikoheshin parime më të larta të menaxhimit të mirë. Ekspertët e PROGRES-it përgatisin vlerësimin gjithpërfshirës si dhe rekomandimet për mënyrat për tejkalimin e pengesave.

PROGRES-i kavendqëndrim në zyren në kuadër të Ministrisë për ekonomi dhe zhvillim regional (MERR) me cka është vërtetuar partneritet i fortë me këtë Ministri, kurse ka vendosur bashkëpunim me Zyren për zhvillim të qëndrueshëm të rajoneve të pazhvilluara.

Në fund, PROGRES-i ka qenë një nga partnerët kryesor në organizimin e dy vizitave të mëdha të ambasadorëve në Serbinë jug-perëndimore në mars, të cilat kanë siguruar vizibilitet të mirë të PROGRES-it dhe gjatë të cilave janë dërguar disa nga mesazhet kryesore në pikëpamje të prioriteteve zhvillimore. Gjatë tremujorit të parë në vitin 2011 janë publikuar më shumë se 150 tekste lidhur me aktivitetet e PROGRES-it kurse faqja e internetit të PROGRES-it ka shënuar rreth 2.800 vizitor. Të dy këto informacione vërtetojnë se mesazhet e PROGRES-it arrijnë deri tek auditoriumi i gjerë dhe krijojnë kushte për zbatimin e ndikimit të rëndësishëm.

MAACRT